



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0227

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Krytera, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “TSR SH.P.K.”e parashtuar kundër Vendimin për dhënie për procedurën e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” me nr. të prokurimit: "214-22-12927-1-1-1", iniciuar nga MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHMEnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) , me 17.05.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE “TSR SHPK” Nr. 2024/0227, e parashtuar me datë 17.03.2024 , ndërsa, vendimi për dhënie të kontratës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në cilësinë e autoriteti kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” numër 214-22-12927-1-1-1, mbetet në fuqi.

2. Bëhet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore në emër dhe për llogari të ankuesve OE “TSR SHPK” të cilët në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duhet të ushtrojnë kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.12.2022, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHMEnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” me nr. të prokurimit: "214-22-12927-1-1-1". Ndërkaq me datën 01.03.2024 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK me të cilin ka shpërblyer me kontratë GOE “G.S.G SH.P.K.; KIG d.d.”

(OE) “TSR SH.P.K.” me datën 06.03.2024 ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK-së të datës 01.03.2024. AK me datën 08.03.2024 e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “TSR SH.P.K.” me 17.03.2024, ka parashtuar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2024/0227, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues

lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Në fazën e shqyrtimit paraprak,

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues, çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake siç kërkohet me nenin 108/A të këtij Ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar siç përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, dhe nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet e parapara me nenin 111, do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas dispozitave të cituara dhe bijën nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105 të LPP, lidhur me nenin 9 të Rregullores për Punën e OSHP.

Bazuar në veprimet si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar, i cili:

- Me 02.05.2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit Nr. 2024/0227, lidhur me pretendimet ankimore të OE “TSR SHPK”.
- Konstatohet se në këtë raport të lartcekur përmban rekomandimin si në vijim:
- Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me tërësinë e shkresave të kësaj lënde sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar andaj Paneli konsideron se ka kushte të vendos në mënyrë meritore. Në të vërtetë pjesë përbërëse e shkresave të kësaj lënde është Raporti i Forenzikës dhe Raporti i Fakultetit Teknik të Prishtinës, i datës 26.07.2023, i kërkuar sipas Vendimit të këtij Organi PSH. Nr. 167,169,170,178/23, datë 13.06.2023, me të cilin disponojnë palët. Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkritazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në këtë rast Paneli konstatoi se AK ka zbatuar:

- a. procedurë të hapur;
- b. lloji i kontratës: Furnizim;
- c. vlera e parashikuar e kontratës: 2,632,297.70 €.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me nenin 4, paragrafi

1.75 të LPP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka pasur nevojë të konvokohet seanca publike me palë në kuptim të paragrafit 2, të Rregullores së cituar, mbajtur me 28.12.2023, për vlerësimin objektiv të pretendimeve dhe në interes të një vendimi sa më të drejtë. Paneli në këtë rast analizoi pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve, ekspertizave e cituara dhe në përmbledhje, konstatohet:

Ankuesi "TSR" SHPK

Sipas ankuesit, në një përmbledhje të pretendimeve ankimore, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten për të disatën herë, ka pretenduar se AK ka shkelur nenin 1, 7, 27, 28, 29 dhe 53 të LPP (të cituar sikurse në ankesën e ankuesit) sepse gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes tenderit (DT). Po ashtu, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar paragrafin 4 të këtij neni, duke shpallur OE që realisht dhe faktikisht është i papërgjegjshëm. Tutje pretendon OE i rekomanduar ka të meta sepse nuk ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke aluduar se test raporti nuk ishte në rregull edhe me vet konfirmimin e vet laboratorit të DEKRA, Çertifikatat ISO 7591 dhe testimi jo sipas standardit ISO 7591 si dhe raporti i testimi i lëshuar nga Laboratori ZAG nga Sllovenia nuk është i vlefshëm sepse ky Laborator nuk është i Akredituar për testim sipas standardit ISO 7591. Në përgjithësi ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP të RK 04/l-042, nenet: 1, 7, 10, 11, 27, 28, 29, 53, 59, 60, 69 dhe 72. Në i kërkojmë OSHP të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK, si lënda të kthehet në ri-vlerësim. Lidhur me të gjitha këto pretendime të cilat janë përmbledhur por janë pjesë e ankesës dhe raportit të ekspertizës, eksperti shqyrtues sqaron se Çështja e mostrave të ofruara nga OE tani i rekomanduar për kontratë, siq pretendon OE ankues se nuk janë në pajtim me specifikacion teknik është trajtuar dhe vendosur përmes vendimit të OSHP-së nr.809-810-811/23. Para vendimit të fundit të OSHP-së kjo çështje po ashtu është trajtuar edhe nga Agjencia e Forenzikës dhe Fakultetit Teknik dhe asnjëri raport i këtyre institucioneve nuk i mbështet pretendimet e OE ankues. OE ankues pretendon se laboratori ZAG i cili ka bërë testimin e folies me stampimit të nxehtë nuk është laborator i akredituar. Pas hulumtimeve të bëra kemi gjetur se ZAG nga Sllovenia është i akredituar në pajtim me ISO 17025, standard ky përmes të cilit përcaktohen kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar laboratorët e testimit dhe kalibrimet. Sipas të njëjtit standard është i akredituar edhe laboratori i cili ka kryer testimet e mostrave të OE ankues. Megjithatë OE ankues pretendon se ZAG nuk është i akredituar për testime lidhur me ISO 7591, dhe ky pretendim në parim qëndron, në kuptimin e asaj që në aneksin ku gjinden fusheveprimi/testimet që kryen laboratorit ZAG nuk shënon standardin 7591. Megjithatë duhet të shtojmë se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, kërkesa e dosjes ka qenë që testimit të bëhet për plotësimin e standardit ISO 7591 për foli me stampim të nxehtë nga një laborator i akredituar, dhe raporti i testimit nga ZAG sipas mendimit tonë plotëson dy këto kërkesa, pasi ZAG është laborator i akredituar, dhe i njëjti ka lëshuar raport testimit sa i përket folies me stampim të nxehtë. Sido që të jetë, OE ankues në ofertë ka ofruar edhe certifikatën e testimit nga DEKRA e cila është e akredituar për testim ISO 7591 e cila ka lëshuar raport pozitiv. OE ankues në ankesë ofron dëshmi një email nga DEKRA, përmes të cilës pretendon se dëshmohet se certifikata e testimit për ISO 7591 nga OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes. Megjithatë pas analizimit të këtij emaili, vlerësimi jonë është se përgjigja nga DEKRA përveç se konfirmon se mostrat janë testuar dhe janë në pajtueshmëri me ISO 7591, të njëjtat kanë qenë me folie të zeza me stampim të nxehtë. Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se gjitha pretendimet ankimore veq kanë qenë objekt i shqyrtimit në OSHP dhe për mendimin tonë duhet trajtuar si çështje e gjykuar. Sa i

perket pretendimeve per qasje te kufizuar, sqarojme se OE ankues ne oferte ka deklaruar dokumentet e cekura si sekret afarist pasi te njejtat nuk jane publike, dhe ne cilesi te ekspertit nuk kemi autorizim per zbulimin e ketyre dokumenteve

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues në ankesën 2024/0227 në bazë të rekomandimit të ekspertit teknik dhe profesional konstatojmë se aktiviteti i prokurimit duhet të mbetet në fuqi.

Në fakt (pavarësisht nga rekomandimet), Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në raportin e ekspertit shqyrtues profesional, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, si dhe në bazë të paragrafit 4 të po këtij nenit të LPP që "Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, (ii) të veprojë në mënyrë **proporcionale** me shkëljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.". Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar edhe nga ana e ekspertit shqyrtues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues profesional, janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore dhe në bazë të këtyre shpjegimeve të ekspertit shqyrtues për të cilat ky Panel ja fal besimin, nuk vërehet/evidentohet se AK ka bërë shkëlje të cilat dëmtojnë procesin e prokurimit dhe janë bazë e qëndrueshme që ky aktivitet të kthehet prap në ri-vlerësim. Si dhe Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, pasi që kjo lëndë është iniciuar në vitin 2022 dhe përseritur që disa herë dhe konform Rregullores së Punes së OSHP-së konkretisht neni 16.3 cituar, në rastet e perserituar me pretendime të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, paneli shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuara "res judicata" në kuptim të nenit 105.2.16 të LPP-së. Në këtë rast jo të gjitha pretendimet janë të njëjta por ankuesit dhe materia e kësaj lënde për të cilat ekzistojnë Raporti i Forenzikës dhe Raporti i Fakultetit Teknikështë si dhe është gjykuar disa herë me vendimet e OSHP-se për këtë aktivitet 2023/0167, 2023/0169, 2023/0170, 2023/0178, 2023/0809, 2023/0810, 2023/0811, dhe së fundmi ky vendim me Nr. 2024/0227.

Paneli Shqyrtues me fjalë tjera konsideron se AK ka ri-vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe AK është i obliguar për të respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë

asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operator ekonomik” si dhe neni 59 par. 4 LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmërinë me të gjitha gjërat e parashtruara në njoftimin e kontratave dhe në dosjet e tenderit”, duke ju përmbajtur kriteret e përgjegjësive. juridike që lidhur me njoftimin për kontratat dhe dosjet se tenderit duke respektuar kriteret e dhënies, tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si dhe është respektuar edhe neni 60 i LPP-së. Andaj paneli marr parasysh natyrën e e këtij aktiviteti të prokurimit i cili është iniciuar që nga viti 2022 dhe i cili është përcjellur me shumë vendime në OSHP dhe për të cilin ka pasur disa vlerësime edhe nga ekspertët teknik edhe nga komisionet e vlerësimeve në AK, por edhe me raporte dhe të forenzikës dhe të Fakultetit teknik, atëherë, vendos që mos ta prolongoj këtë aktivitet të prokurimit edhe më tutje, por duke u bazuar në nenet 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të LPP dhe nenin 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç’rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit. Vlenë të theksohet se edhe në seancën publike të mbajtur me palë me datë 28.12.2023, lidhur me vendimet paraprake, OE tani i rekomanduar për kontratë në prezencë edhe të përfaqësuesëve të autoritetit kontraktues, ka deklaruar se i njëjti posedon kontratën aktuale dhe autoriteti kontraktues nuk ka pasur asnjë herë ndonjë vërejtje gjatë ekzekutimit të kontratës.

Duke u nisur nga këto fakte të lartcekura dhe të gjeturat e ekspertit profesional, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK, të mbetet në fuqi vendimi i AK, vendim ky që është vendimi i një komisioni i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”, nga ana tjetër edhe eksperti shqyrtues konform autorizimeve të tija të parapra me nenin 113 dhe 114 të LPP, mbështet rekomandimin e komisionit profesional për zgjedhjen e OE të rekomanduar, Paneli bazuar në të gjitha këto prova të administruara si më sipër dhe në kuptim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta zgjasë aktivitetin e prokurimit pa ndonjë arsye konkrete dhe pa ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i ligjit është mes tjerash, cituar: “...të sigurtë integritetin dhe përgjegjësinë e tyre. zyrtarëve, nëpunësve civilë dhe të tjerëve që kryejnë janë të përfshira në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e tyre janë të tilla dhe baza ligjore faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo - diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të të gjitha këto procedurale dhe qenësore të ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se ankesa e OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e ekspertëve.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet ne fuqi vendimi i AK, sepse është të diskrecion të AK edhe në rast të aplikimit të devijimeve të vogla siç përcakton edhe legjislacioni ne fuqi konkretisht neni 59 par. 4 të LPP-së, ku përgjegjesin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet ne përgjegjesi dhe diskrecion të Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar. Ndërsa, lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP, sa i përket qasjes në dokumente publike, AK nuk ka vepruar konform këtyre neneve, andaj, Paneli shqyrtues ju bënë me dije ZPP të AK, se nëse në të ardhëm evidentohet një shkelje e tillë, atëherë OSHP do ti drejtohet KRPP me një kërkesë për revokim të çertifikatës konform neni 25, paragrafit 8 dhe 9 të LPP. Dhe mbi bazën e kësaj paneli ka vendos që ankesa të kualifikohet si pjesërisht e bazuar dhe ti kthehet tarifa e ankesës.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, Paneli shqyrtues duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

- **OE - TSR SH.P.K.**
- Arkivēs sē OSHP-sē: